REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 237/22
Datë/Datum. 12.08.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 237/22

PANELI SHQYRTUES,i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të znj. Kimete Gashi– Kryetare , znj. Nita Bejta-Referuese, z. Vedat Poterqoi–Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE "ER-LIS sh.p.k–Pejë, kundër njoftimit për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull:"Shenjëzimi i rrugëve dhe objekteve në fshatrat dhe qytetin e Malishevës" me nr. të prokurimit: 62500-22-5465-1-2-1, iniciuar nga AK – "KK Malishevë", më datën:.., mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: OE "ER-LIS sh.p.k–Pejë, kundër njoftimit për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Shenjëzimi i rrugëve dhe objekteve në fshatrat dhe qytetin e Malishevës" me nr. të prokurimit: 62500-22-5465-1-2-1, iniciuar nga AK – "KK Malishevë.

II.ANULOHET, njoftimi për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Shenjëzimi i rrugëve dhe objekteve në fshatrat dhe qytetin e Malishevës" me nr. të prokurimit: 62500-22-5465-1-2-1, iniciuar nga AK –"KK Malishevë ,dhe lënda kthehet në **Rivlerwsim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: OE "ER-LIS sh.p.k–Pejë,i aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues, që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: OE "ER-LIS sh.p.k–Pejë,si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 28.06.2022 me nr. 237/22, kundër njoftimit për kontratë, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Shenjëzimi i rrugëve dhe objekteve në fshatrat dhe qytetin e Malishevës" me nr. të prokurimit: 62500-22-5465-1-2-1, iniciuar nga AK – "KK Malishevë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7,28,66,69 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 29.06.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 06.07.2022, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sqarim Hyrës: Autoriteti Kontraktues - "Komuna Malisheve", gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim (kontratë kornizë 36 muaj) me vlerë të mesme. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për kontratë.

- Kundër të njëjtit njoftimi parashtruesi i ankesës "Er Lis" shpk - Pejë, më datën 23.06.2022, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, me pretendimet e njëjta ankimore si ne ankesën e dorëzuar në OSHP.

Përderisa AK – Komuna Malisheve, përmes vendimit te datës se njëjtë refuzon kërkesën si të pa bazuar, me arsyetimin se nuk ndryshohen kushtet e njoftimit për kontratë dhe dosjes se tenderit.

Përgjigjje në pretendimin ankimor 1 (neni 113) :

Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se parashtruesi i ankesës pretendimet i ka ngritur kundrejt kërkesave te kualifikimit, përkatësisht kundër pikës 3.1, te FDT-se ku AK , ka kërkuar deklarate për specifikacionet teknike per mallrat e ofruara te cilat përputhen me ato te përmendura ne aneksin 1"

- Sipas dosjes së tenderit përkatësisht aneksi 1, nuk përmban specifikacione teknike të detyrueshme, rrjedhimisht pretendimi dhe kërkesa e parashtruesit te ankesës ka qenë e qartë dhe konkrete, megjithatë AK, nuk e ka trajtuar fare të njëjtin pretendim.

Pretendimi tjetër ndërlidhet me pozicionin 3, të kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional ku AK – Komuna Malisheve ka kërkuar: "Ekspert i Licencuar për siguri dhe shëndet ne pune ne profilin e Komunikacionit, i Licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale". Është kërkuar në arsyetim për kërkesë të tillë dhe është konsideruar si kërkesë qe e kufizon

konkurrencën dhe bie ndesh me parimet e përgjithshme te Prokurimit Publik. Edhe për ketë pikë Autoriteti Kontraktues – Komuna Malishevë nuk ka dhënë arsyetimi siç obligohet me dispozitat e nenit 108/A, te LPP-së.

Paragrafi 9, i nenit 108/A, të LPP-së përcakton: "Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim".

Se bashku me raport si provë gjeni kopjen e vendimit kundrejt kërkesës për rishqyrtim dhe Aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, Er – Lis" shpk – Pejë, të aprovohet ne tërësi si e bazuar dhe të obligohet AK – Komuna Malishevë që lëndën ta kthej në Ri shqyrtim dhe ne ri vendosje siç parashihet me dispozitat e nenit 108/A, te LPP-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me raportin e ekspertizës me datë: 06.07.2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka njoftuar OSHP-në, se a pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datën: 06.07.2022, me anë të parashtresës , ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka mbajtur sencwn e mbyllur me datën 10.08.2022 ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të

ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënien e kontratës,ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Paneli shqyrtues sa i perkete pretendimi 1. duke u bazuar konkretisht ne kërkesat e dosjes se tenderit ku jane përpiluar specifikime teknike duke kwrkuar , sipas FDT-se pika 3.3. "Ekspert i Licencuar për siguri dhe shëndet ne pune ne profilin e Komunikacionit, i Licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale" me ç 'rast ka kufizuar pjesëmarrjen e operatoreve ekonomik të interesuar për këtë aktiviteti të prokurimit,andaj paneli shqyrtues urdhëron autoritetin kontraktues qe te respektoj dispozitat ligjore nga Neni 28 par.2 i LLP-së dhe te përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale -Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

znj. Kimete Gashi